



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE
Seria e Analizave Politike 2012/02

**VIZIONI GJITHËPËRFSHIRËS
PËR VERIUN
MUNDËSIA E FUNDIT**

Prishtinë, shkurt 2012

Përgatitur nga: Shpend Kursani

E drejta autoriale © 2012 nga KIPRED. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të informacionit, apo të transmetohet, në ndonjë formë ose përmes mjeteve elektronike, mekanike, fotokopjuese, të incizimit apo në ndonjë formë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit. Ju lutem të kontaktoni në info@kipred.net or +381 38 227 778.

I botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Rr. Rexhep Mala, Nr 5A
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel dhe Fax: +381 38 227 778
www.kipred.net

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Qarku vicioz: prej status quosë në status quo.....	5
3. Politika, krimi, dhe jeta në veri	7
a. Politika.....	7
b. Krimi i organizuar dhe jeta.....	8
4. Dështimi i “Strategjisë për veriun e Kosovës”	9
5. Zbehja e Brukselit dhe ngritja e Berlinit.....	11
6. Shumë elemente në lëvizje gjatë vitit 2012.....	14
7. Rruga përpara.....	15
a. Faza e I: Faza emergjente (3 muaj).....	16
b. Faza e II: Faza e akomodimit (1 vit)	17

1. Hyrje

Njoftimi nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) se procesi i mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës mund të përfundojë kah fundi i vitit 2012 vuri në theks urgjencën e zgjidhjes dhe të ri-integrimit të Kosovës veriore me pjesën tjetër të shtetit. Çdo vonesë në zgjidhjen e kësaj çështje do ta rrisë potencialin për konflikt brenda Kosovës, si dhe do të nxisë paqëndrueshmëri rajonale si pasojë e rritjes së ekstremizmit, duke shkaktuar kështu vonesa në procesin e integrimit në Bashkimin Evropian (BE).

Prania ndërkombëtare nuk ka arritur të ofrojë sundimin e ligjit në veri për shkak të mungesës së vullnetit dhe përcaktimit të tyre politik. EULEX, misioni më i madh i ndërmarrë nga Politika e Përbashkët për Mbrojtje dhe Siguri (CSDP) e Bashkimit Evropian i ka vetëm disa zyrtarë në terren dhe nuk merr masa në parandalimin e aktiviteteve të ekstremistëve serbë dhe grupeve kriminale. Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) pret një zgjidhje politike dhe nuk tregon vullnet për të ndërmarrë masa kundër aparatit të sigurimit të Serbisë, i cila vepron në mënyrë të paligjshme në veriun e Kosovës. Që të dy misionet, KFOR dhe EULEX, kritikojnë privatisht njëri-tjetrin se nuk e po e kryejnë si duhet punën e vet në veri. Ngjashëm edhe udhëheqja e Kosovës nuk ka hartuar ndonjë plan për ri-integrimin e kësaj zone, e as që ka mundur të komunikojë me komunitetin serb për t'ua zbutur frikën. Njëkohësisht, Serbia vazhdon të përkrah status quonë ekzistuese. Mirëpo, në gusht të vitit 2012 duke kuptuar se ndarja e Kosovës nuk do të realizohej Serbia ka lëvizur drejt idesë për krijimin e një entiteti në veri, i cili teknikisht do të ishte nën sovranitetin e Kosovës, mirëpo në realitet do të kontrollohej tërësisht nga Beogradi.

Bashkësia ndërkombëtare ende po mundohet të gjejë një mënyrë ku zgjidhja për veriun të arrihej në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Përfundimi i ka përdor veriun për të qetësuar udhëheqjen demokratike post-milloseviqiane të Serbisë, qëllimi të cilëve ka qenë ndarja e Kosovës, si dhe për të ndikuar tek udhëheqja në Prishtinë për t'i përmirësuar dukshëm kushtet e serbëve të Kosovës në jug të lumit Ibër dhe kësajsoj "të fitojnë" të drejtën për ta qeverisur territorin. Disa nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe qarqet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), kanë luajtur me idenë e ndarjes. Ka pasur edhe qarqe të udhëheqjes politike të Kosovës, të cilat e kanë konsideruar ndarjen dhe shkëmbimin e territoreve me Serbinë si një opsion për përfundimin e kësaj situatë të pandryshueshme në veri. Duke marrë parasysh efektin që mund ta ketë për rajonin ndryshimi i vijave ekzistuese kufitare meqë kërcënon drejtpërdrejtë integritetin territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe të Maqedonisë, ky opsion u përjashtua.

Intervenimi nga Njësitët Speciale për Operacione Regjionale (ROSU) i urdhëruar nga Qeveria e Kosovës (QeK) me 25 korrik 2011 për t'i zbatuar "masat e reciprocitetit tregtar" me Serbinë, kanë bërë që ndërkombëtarët ta refuzojnë me vendosmëri ndarjen e veriut të Kosovës, dhe që zgjidhja e mundshme të gjendet në kuadër të Planit të Ahtisarit. Përderisa intervenimi i QeK e ka ndryshuar status quonë, e cila qe krijuar si rezultat i shpalljes së Pavarësisë në shkurt të vitit 2008, ajo njëkohësisht e ka krijuar një status quo tjetër - duke i forcuar edhe më shumë udhëheqësit radikalë serbë të Kosovës në veri të lumit Ibër, të cilët tani po e shpërfillin edhe Beogradin. Kryetarët e komunave në veri kanë filluar të veprojnë si renegatë sovranë në menaxhimin e punëve që t'u shkojnë përshtati interesave të tyre, duke ndikuar në këtë formë edhe më shumë në ndarjen e tyre nga serbët në jug të Ibrit, të cilët e shohin integrimin e veriut si garanci për zhvillim dhe jetesë në Kosovë.

Refuzimi i përbashkët nga ana e palës ndërkombëtare për ndarje të veriut e ka shtyrë elitën në Beograd, si dhe disa qarqe në Prishtinë, të kuptojnë se zgjidhja për veriun duhet të gjendet përbrenda kufijve ekzistues të Kosovës. Duke u përballur me këtë realitet, Presidenti i Serbisë, Boris Tadic e ka propozuar një plan 4 pikësh¹, përderisa udhëheqja në Prishtinë vazhdon me qëndrimin se çfarëdo zgjidhje për veriun e Kosovës duhet të gjendet në kuadër të Planit të Ahtisaarit. Prania ndërkombëtare duket se nuk ka ide të qartë se si do të dukje një zgjidhje afatgjatë ; ata vazhdojnë ta debatojnë këtë çështje mes vete, duke e analizuar “modelin e zgjidhjes” të prezantuar nga disa ndërmjetësues në Kosovë, Serbi dhe Perëndim. Aktorët ndërkombëtarë në Kosovë pajtohen që: Prishtina duhet të paraqes një “ofertë” për veriun dhe ta udhëheq këtë proces. Një pyetje që mbetet pa përgjigje është se deri ku Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e pastaj Serbia janë të gatshme të pranojnë ndonjë plan të QeK, duke marrë parasysh përvojën e hidhur me “Strategjinë për veriun e Kosovës”² e cila ishte torpeduar nga Brukseli në shkurt 2010, vetëm një muaj pasi që ishte paraqitur.

Po të vazhdojë situata e tanishme ose nëse veriu fiton një status të ndryshëm me atë të statusit të serbëve në jug të lumit Ibrër do të rrezikohet jo vetëm paqja dhe stabiliteti në Kosovë por edhe në rajon. Kjo do ta rrisë potencialin për një konflikt ndëretnik, dhe do të nxisë ekstremizmin potencial në shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor.

2. Qarku vicioz: prej status quosë në status quo

Veriun e Kosovës e karakterizojnë një numër status quosh që nga qershori i vitit 1999. Situata në rajon ka qenë e vështirë të kuptohet sado herë që është krijuar një status quo e re, si rezultat i tentativave për ta ndryshuar “gjendjen ekzistuese” dhe për ta vendosur sundimin e ligjit ose si rezultat i konfliktit ndëretnik të përmasave të ndryshme. Intervenimi i ROSU’s ishte tentativa e fundit për ta vendosur sundimin e ligjit duke dërguar doganierët e QeK në dy portat veriore, 1 dhe 31, veprim ky që solli deri tek status quoja e tanishme e karakterizuar me ngritjen e barrikadave, me një qëndrim më radikal të udhëheqësve radikalë lokalë ndaj institucioneve të Kosovës, si dhe tensione të larta politike.

Ishin pesë zhvillime të cilat i dhanë formë veriut, ku secila solli deri tek një status quo, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e situatës politike dhe shoqërore në këtë pjesë të Kosovës:

1. *Qershor 1999*: Trupat e NATO’s hyn në Kosovë derisa aparati ushtarak dhe ai i sigurimit Jugosllav (serb) po tërhiqej. Me ikjen dhe përjashtimin e serbëve të Kosovës nga qendrat urbane në jug të lumit Ibër, veriu i Mitrovicës bëhet e vetmja qendër urbane për serbët ku ata takohen dhe konsolidohen më përkrahjen e Beogradit. NATO-ja e krijoi “tampon zonën” te ura e Mitrovicës. Një numër i Shqiptarëve të Kosovës të larguar kthehen në shtëpitë e tyre në veri të qytetit. Serbët krijojnë “Rojet e Urës” me ndihmën e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) të Serbisë dhe Agjencisë së Inteligjencës (BIA).

¹ 4 Pikat janë:

(1) një zgjedhje speciale për veriun e Kosovës;
(2) administrim i manastireve Serbe dhe komplekseve monastike;
(3) garanci speciale për Serbet nëpër enklava; dhe
(4) rregulloret mbi pronën e qytetarëve Serb dhe shtetit të Serbisë.

² “Strategjia për veriun e Kosovës” ishte përgatitur bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) në Janar 2010

2. *Shtet 2000*: Ekstremistët serbë vranë 11 shqiptarë të Kosovës në veri të Mitrovicës, që rezultoi në një eksod të deri 6,000 shqiptarëve të Kosovës nga veriu i Kosovës (tani kanë mbetur 3,000). KFOR-i francez i shikoi me qetësi dhe nuk u ofroi mbrojtje shqiptarëve që po iknin. Ky rast e vulosi njëherë e mirë përbërjen etnike në pjesën veriore të qytetit me 12,000 serbë; 3,000 shqiptarë, dhe 2,000 anëtarë të bashkësive të tjera etnike.
3. *Mars 2004*: Pas fundosjes së tre fëmije shqiptarë të Kosovës në lumin Ibër për çka ishin fajësuar serbët, shpërtheu dhuna ndëretnike e dy ditëve në vijim – 17 dhe 18 mars. Dhuna rezultoi në 19 të vdekur (11 shqiptarë të Kosovës, 8 serbë të Kosovës); 4,000 serbë të Kosovës u zhvendosen; dhe u dëmtuan një numër i kishave ortodokse dhe i manastireve.
4. *Shtet dhe mars 2008*: Dy ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, portat 1 dhe 31 u dogjën nga ekstremistët serbë të përkrahur nga Beogradi. Një muaj më vonë filloi konflikti mes serbëve dhe forcave të KFOR-it në veri të Mitrovicës pasi që KFOR vendosi ta marr kontrollin mbi gjykatën e qytetit. Pasi QeK e filloi zbatimin e dispozitave të Planit të Ahtisaarit në tërë territorin e Kosovës, roli i UNMIK-ut u zbeh de fakto me përjashtim në veri të Kosovës. Me qëllim që të sigurohet vendosja e EULEX-it si dhe normalizimi i veriut, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e propozoi – në konsultim me Serbinë, ShBA-të, BE-në dhe Rusinë, planin 6 pikësh³. Prishtina e refuzoi këtë plan.
5. *Korrik 2011*: Qeveria e Kosovës e dërgoi njësinë e ROSU-s t'i zbatojë masat e reciprocitetit të tregtisë, pasi që EULEX refuzoi që ta zbatojë një vendim të tillë në portat 1 dhe 31. Këto masa u ndërморën atëherë kur Serbia refuzoi t'i pranonte vulat doganore të Kosovës për të pamundësuar tregtinë me Kosovën⁴.

³ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Misioni për Administrim të Përkohshëm të Kosovës, 24.11.2008, S/2008/692

- (1) Policia – *Formimi i nën stacioneve shtesë në zonat e minoriteteve; UNMIK do të emëroj një zyrtarë të lartë Serb të Kosovës; Policia në Kosovë mbetet nën mbikëqyrjen ndërkombëtare;*
- (2) Doganat – *Kosova do të vazhdojë të funksionojë si një pikë doganore; zyrtarët e ndërkombëtar të doganave të emëruar në bazë të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) do të vendosen në portat 1 dhe 31. Ndryshimet për zbatimin e tyre do të reflektojnë aq sa është e mundur konceptin e menaxhimit kufitar Evropian; Diskutimet e mëtutjeshme nevojiten për të hyrat doganore të mbledhura në portat 1 dhe 31, sipas nevojës në zhvillimin e komunitetit lokal;*
- (3) Drejtësia – *Diskutimet e mëtutjeshme për hartimin e principeve, kompleksi i gjykatës në veri të Mitrovicës rishtazi është vu në funksion të kufizuar nën kontrollin e UNMIK-ut, duke aplikuar vetëm ligjet e UNMIK-ut, dhe me personel të UNMIK-ut për një periudhë 60 ditësh prej ditës së hapjes së gjykatës; Gjatë periudhave në vijim, gjyqtarët vendor dhe prokurorët do të emërohen në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999);*
- (4) Transporti dhe infrastruktura – *Diskutimet kanë theksuar nevojën për bashkëpunim të përafërt në çështjet madhore të infrastrukturës (rrugë, hekurudha, ujë, rrymë elektrike), qarkullimi i trafikut dhe tregtia janë çështje praktike të rëndësishme, po ashtu sikur edhe pranimi i kualifikimeve;*
- (5) Kufijtë – *Shumë nga çështjet të rëndësishme për menaxhimin e kufijve do të adresohen nga procesi i komitetit teknik për transport dhe infrastrukturë. Ndryshe, sikur edhe u theksua në raportin tim të mëhershëm, në përputhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999), KFOR, si prezenca ndërkombëtare ushtarake do të ushtrojë mandatin e vet të sigurimit në tërë Kosovën, përfshirë këtu edhe kufijtë, në bashkëpunim me organizatat tjera ndërkombëtare; dhe*
- (6) Famullia Serbe – *Mbrojtja ndërkombëtare e Kishës Ortodokse në Kosovë do të vazhdojë; agjenda do të përfshijë edhe implementimin e aranzhimeve mbrojtëse rreth hapësirave të Kishave Ortodokse Serbe, aktivitetet të ndërlydhura me mirëqenien e murgjve dhe motrave të nderit, si dhe lirim nga tatimi i vlerës së shtuar, akcizës dhe doganave, ndryshimet për rindërtimin e hapësirave nga Kisha Ortodokse Serbe dhe çështja e artefakteve arkeologjike.*

⁴ Serbia ka fuqizuar ndalesën për qarkullimin e mallrave dhe njerëzve nga Kosova që nga Shkurti 2008, duke mos i njohur dokumentet e shtetit të ri

Të gjitha këto ngjarje kanë luajtur rol në formësimin e jetës politike, ekonomike dhe sociale në veri të Kosovës. Përpos tri komunave Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq me shumicë popullate serbe, komuna dhe qyteti i Mitrovicës është i ndarë nga lumi Ibër, me një shumicë serbe në veri dhe shumicë shqiptare në jug. Të katër komunat në veri veprojnë nën institucionet paralele politike, ekonomike dhe të sigurisë të instaluar dhe të përkrahura nga Qeveria e Serbisë (QeS).

3. Politika, krimi, dhe jeta në veri

a. Politika

Partitë opozitare të Serbisë, Partia Demokratike e Serbisë (DSS) e Vojslav Koshtunicës dhe Partia Progresive Serbe (SNS) e Tomislav Nikoliqit dominojnë në komunat në veri. DSS e kontrollon Zveçanin, me kryetarin Slavisha Ristiq dhe Zubin Potokun me kryetarin Dragisha Milloviq; komuna e Mitrovicës së Veriut udhëhiqet nga SNS dhe kryetari i partisë Krstimir Pantiq, ndërsa Leposaviqi udhëhiqet nga Partia Demokratike e Tadiqit (DS) nën udhëheqjen e kryetarit Branko Niniq. Anëtari i DS, Radenko Nedeljkoviq është “kryesuesi i qarkut Kosovska Mitrovica”, i cili është përgjegjës për mbikëqyrje dhe ushtron një lloj kontrolli të Beogradit mbi këto katër komuna. Ministria e Serbisë për Kosovë dhe Metohi e udhëhequr nga DS është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve dhe aktiviteteve të tjera politike të Serbisë në vendbanimet me serbë të Kosovës, ndërsa vet ministri (Goran Bogdanović) është nga Leposaviqi.

Të tre kryetarët nga opozita i nënshtrohen më shumë udhëheqësve partiak në Beograd se sa Qeverisë së Serbisë. Ata e shfrytëzojnë veriun për ta penguar Tadiqin si dhe për ta dobësuar atë para zgjedhjeve parlamentare dhe lokale në pranverë të vitit 2012⁵. Udhëheqësit lokalë me histori kriminele, Marko Jakshiq (DSS) dhe Milan Ivanoviq të përkrahur nga Partia Socialiste e Serbisë (SPS), vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në veri, shpesh duke u dhënë formë qëndrimeve të kryetarëve tjerë. Megjithatë, QeS së bashku me zyrtarët e MUP-it dhe BIA-s⁶ ka mundësi t’i mbajnë peng kryetarët rebel, duke njohur përfshirjet e tyre në aktivitetet korruptive dhe kriminele, dhe mund të shfrytëzojnë këtë aparat për t’i nënshtuar ata vullnetit politik të Serbisë nëse Beogradi vendos për diç të tillë⁷.

Me qëllim të zbutjes së radikalizmit serb në veri të Kosovës, në vitin 2008 prania ndërkombëtare në Kosovë u përqendrua në forcimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të serbëve të Kosovës, posaçërisht në veri të Mitrovicës. Në shumicën e rasteve ata janë munduar t’i përdorin OShC-të në Mitrovicë nga dy anët e lumit Ibër me qëllim të zbutjes së tensioneve ndëretnike mes serbëve dhe shqiptarëve, si dhe të promovimit të pajtimit mes palëve. Krijimi i lidhjeve të OShC-ve të Mitrovicës nga dy anët e lumit pritej të sillte më shumë pikëpamje të moderuara, si dhe krijimin e palëve të reja të interesit në qytetin e ndarë. Fatkeqësisht, udhëheqësit e njëres nga organizatat e serbëve të Kosovës me përkrahje më të madhe të donatorëve, të cilët edhe kanë qenë përgjegjës për menaxhimin e Qendrës Informative të BE-së në veri të Mitrovicës u arrestuan në Serbi në vjeshtë të vitit 2011, nën akuzat për kontrabandë të armëve nga Serbia për në veri të Kosovës.⁸

⁵ Zgjedhje lokale dhe parlamentare të Serbisë priten të mbahen me 6 Maj 2012.

⁶ Institucionet e sigurimit të Serbisë, përmes strukturave të MUP dhe BIA’s veprojnë si civil ose nën uniformën e Policisë së Kosovës pa asnjë pengesë në veri të Kosovës, duke shkelur drejtpërdrejtë Rezolutën e KSKB 1244, të cilës Beogradi i referohet shpesh.

⁷ Intervistat e KIPRED-it me udhëheqësit politik të Serbeve të Kosovës, Dhjetor 2011 dhe Janar 2012

⁸ Aliu, F. dhe Barlovac, B. “Policia Serbe Arrestoi Dy Serb të Kosovës - Punëtorë të BE”. 10 Nëntor 2011.

BalkanInsight. [Online] Gjetet në: <http://www.balkaninsight.com/en/article/momcilo-arlov-arrested-in-serbia>

b. Krimi i organizuar dhe jeta

Në veri të Kosovës jetojnë maksimum 40,000 serbë, duke përfshirë këtu edhe rreth 11,000 studentë⁹ që vijojnë studimet në Universitetin e Mitrovicës, dhe përafërsisht 5,000 serbë të zhvendosur nga jugu i lumit Ibër, së bashku me 4,000 shqiptarë, si dhe 3,000 anëtar të grupeve tjera etnike (boshnjak, turq, romë, ashkali, egjiptas - RAE)¹⁰.

Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq¹¹, gjinden në fshatra të izoluar me kontakt dhe bashkëpunim minimal me serbët lokalë, për dallim nga ata që jetojnë në veri të Mitrovicës dhe në jug të Ibrit. Mungesa e sundimit të ligjit në veri ka ndikuar në prosperitetin e popullatës lokale. Ekzistojnë rreth 3,000 përdorues të drogës në atë rajon¹² dhe 67 grupe të përfshira në krim, kontrabandë dhe delikuençë¹³. Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i janë të vetëdijshëm për aktivitetet e dhunshme të këtyre grupeve, por prapë se prapë nuk ndërmarrin veprime për t'i penguar ato. Në përgjithësi, ekstremistët dhe grupet kriminale në veri përfitojnë nga tensionet e nxehta ndëretnike. Ekziston mundësi për rritjen e konflikteve ndëretnike përbrenda veriut nëse nuk ndërmerren masa për të vendosur rendin dhe sundimin e ligjit.

Përderisa jeta është e zbehë për të gjitha komunitetet që jetojnë në veri, grupet e përbashkëta kriminale të përbëra nga serbë dhe shqiptarë të Kosovës, të lidhura me qendrat politike në Beograd dhe Prishtinë, vazhdojnë aktivitetin e tyre, dhe si rrjedhojë ia përshtatin interesave të tyre situatën e tensionuar¹⁴. Komandanti i KFOR-it Gjerman, Major Gjeneral Erhard Dreys e identifikoi Zvonko Veselinoviçin si organizator të përlëshjeve në pikëkalimin në Jarinjë me 27 shtator 2011, ndërsa vëllai i tij Zharko i udhëhoqi të nesërmen sulmuesit kundër KFOR-it në fshatin Jagnjenica¹⁵. Një javë pas deklaratës së hapur të komandantit të KFOR-it mbi aktivitetet e vëllezërve Veselinoviç ata u arrestuan në Kopaonik nga policia shtetërore e Serbisë.

Veriu i Kosovës nuk ishte territor i vetëm ku vepronte Veselinoviçi. Ai e vizitonte jugun e Mitrovicës dhe Vushtrrinë, ku takohej me personalitete të shumta shqiptare të ndërlidhura me biznes dhe politikë¹⁶. Ka indikacione të qarta se Policia e Kosovës ishte e informuar mirë për lidhjet komerciale të Veselinoviçve me partnerët shqiptarë në Prishtinë dhe në pjesë të tjera të Kosovës, por nuk kanë ndërmarrë asgjë për shkak të ndërhyrjeve politike¹⁷. Zyrtarët e Policisë së Kosovës që e kishin vullnetin për të raportuar, për të shkëmbyer informacionin apo për të hedhur dritë mbi këto aktivitete ishin penguar për t'u promovuar, janë degraduar e madje shpesh herë edhe janë larguar nga vendet e punës¹⁸. Policia e Kosovës është e informuar plotësisht se veriu i Kosovës nuk është destinacioni i vetëm i kontrabandës ilegale të mallrave përmes portave 1 dhe

⁹ Shumica e këtyre studentëve janë nga Serbia, Mali i Zi dhe nga vendbanimet Serbe në jug të lumit Ibër.

¹⁰ Këta janë shifra të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës. Ndërsa bazuar në të dhënat nga Ministria Serbe e Shëndetësisë 24,000 Serb të Kosovës janë përfitues të sigurimit shëndetësor, që do të thotë numri i banorëve në veri mund të jetë në mes të 32,000 -35,000, shifër kjo që përdoret nga QeS.

¹¹ **Leposaviq**–Përafërsisht 200 Shqiptar të Kosovës jetojnë në tri fshatrat jugore: Kushtovë, Bisticë e Shalës, dhe Cerajë; **Zubin Potok** - Përafërsisht 800 Shqiptarë të Kosovës jetojnë në fshatin Çabër; **Zveçan** – Rreth 350 Shqiptar të Kosovës jetojnë në fshatrat Boletin, Lipë dhe Zhazhë.

¹² Hysa, Y., et al. (2011). *Raporti për institucionet paralele në veri të Kosovës*. Zyra e Koordinatorit për Strategji për Veriun e Kosovës. (f.7)

¹³ Ibid.

¹⁴ KIPRED Intervistë me Zyrtar të Lartë të Policisë së Kosovës, Prishtina, 20.01.2012

¹⁵ Jovanović, I. "Arrestimi i Veselinoviçit nxit kundërtëhëniet në Serbi". 22 Dhjetor 2011. *SETimes*. [Online] Gjetendet nw:http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/12/22/feature-01

¹⁶ KIPRED intervista me Zyrtarin e Policisë së Kosovës, Mitrovicë, 18.01.2011; dhe Zyrtar i Lartë Perëndimor që punon në Kosovë, Prishtinë, 25.01.2011

¹⁷ KIPRED Intervistë me Zyrtar të Lartë Perëndimor që punon në Kosovë, Prishtinë, 25.01.2011

¹⁸ KIPRED intervistë me zyrtarë të lartë të Policisë së Kosovës, Mitrovicë, 18.01.2011

31, sepse sasia e këtyre mallrave të kontrabanduara është dhjetëfish më e madhe se nevojat e veriut të Kosovës¹⁹. Një shembull i tillë është sasia e madhe e naftës e cila hyn nëpër këto porta²⁰. Përpos politikës së Beogradit ndaj veriut, janë edhe grupet e organizuara kriminale dhe patronët e tyre politik të cilët e kundërshtojnë vendosjen e rendit dhe të ligjit në këtë pjesë të Kosovës.

KFOR, EULEX, Policia e Kosovës, të cilët e kanë përgjegjësinë për vendosjen e rendit dhe të ligjit, e kanë lënë në harresë situatën atje për shkak se nuk ka ekzistuar vullnet politik i shteteve kryesore perëndimore pastaj për shkak të ndasive midis shteteve anëtare të BE-s në qasjen ndaj Serbisë dhe statusi të Kosovës, si dhe për shkak të mungesës së një vizioni kuptimplotë të Prishtinës për ri-integrimin e veriut. Po ashtu, Brukseli duke iu frikësuar viktimitave nëse misioni i EULEX-it fillon ta ekzekutojë mandatin e vet në veri të lumit Ibër filloi të llogariste në Beogradin që të merret me strukturat kriminale në këtë anë. Gjykata jo-funksionale në veri të Mitrovicës shërben si barometër i efikasitetit të EULEX-it. Edhe Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën vë në dukje se gjykata e Mitrovicës, e cila përbëhet vetëm nga gjykatësit dhe prokurorët e EULEX, vepron me kapacitete të kufizuara, e që e zvogëlon qasjen në drejtësi dhe pengon sundimin e ligjit.²¹ Për më tepër nuk ka gjykatë komunale apo gjykatë për kundërvajtje e cila funksionon në veri, dhe se nuk ka pasur asnjë rast civil të proceduar që nga fillimi i vitit 2008²². Në të vërtetë, Perëndimi e ka mbajtur status quon në veri, duke manovruar mes Prishtinës dhe Beogradit, kryesisht për ta ruajtur fytyrën e establishmentit post-Millosevician në Serbi, përderisa veriu është mbajtur i ndarë dhe është përdorur si shkop për udhëheqjen shqiptare të Kosovës me qëllim që Prishtina të krijojë një Kosovë shumë-etnike.

4. Dështimi i “Strategjisë për veriun e Kosovës”

Tentativa e parë serioze nga prania ndërkombëtare dhe Qeveria e Kosovës për të lëvizur nga status-quoja ekzistuese në veri erdhi në fillim të vitit 2010 më përpilimin e përbashkët të “Strategjisë për Veriun e Kosovës” nga Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) dhe QeK²³. Kjo strategji është fokusuar në forcimin e sundimit të ligjit, decentralizim dhe krijimin e komunës së Mitrovicës veriore; trajtimin e çështjes së qeverisjes në tri komunat veriore (Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq); dhe përmirësimin e situatës politike, ekonomike dhe sociale. Ajo ofron rekomandime për secilin nga këta komponentë, duke i identifikuar veprimet që duhet të ndërmerren nga të gjithë aktorët përgjegjës ndërkombëtarë dhe vendorë.

Në këtë dokument përvijoheshin hapat konkret, rekomandimet dhe planet e veprimit për aktorët kryesorë në çështjet politike dhe ato të sigurisë - EULEX, ZCN dhe Qeveria e Kosovës. Hapi kryesor për çfarëdo progresi ekonomik apo politik në veri ishte sundimi i ligjit. Sundimi i ligjit duhet të zbatohet nga EULEX-i, në koordinim me përpjekjet për forcimin e zyrarëve të Policisë së Kosovës në këtë anë. Strategjia thekson se “suksesi në forcimin e sundimit të ligjit në veri [...] do të ndikojë në mundësinë e aktorëve lokalë dhe ndërkombëtarë ta promovojnë progresin në veri”²⁴. Më tutje, Strategjia thekson se “Serbët e Kosovës në veri, të cilët interesohen të marrin pjesë në proceset politike në Kosovë ballafaqohen me kërcënime nga ekstremistët dhe strukturat paralele. Kërcënimet

¹⁹ Ibid.

²⁰ Ibid.

²¹ Komisioni Evropian (2011). Raporti i Progresit të Kosovës. [Online] Gjetet në:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

²² Ibid

²³ QeK dhe ZCN (2010) Strategjia për Veriun e Kosovës

²⁴ Ibid. (p.3)

dhe dhuna mund të parandalohen me anë të një pranie më të dukshme dhe më të fuqishme të sundimit të ligjit²⁵. Strategjia propozon një sërë hapash për krijimin e komunës së Veriut të Mitrovicës, mbajtjen e zgjedhjeve, si dhe propozon masa për t'iu qasur çështjeve socio-ekonomike.

Sa i përket Serbisë, dokumenti thekson se “Beogradit duhet t’i jepet shtytje dhe alternativa në lidhje me politikën e tanishme të mbajtjes së strukturave paralele dhe pengimit të bashkëpunimit mes të serbëve të Kosovës dhe autoriteteve të Kosovës [...] stimulimi më të rëndësishëm për Beogradin ndërlihet me perspektivën evropiane të Beogradit, e cilat varet nga reformat e ndërlihdura me procesin e integritetit dhe këndvështrimet e shteteve anëtare të BE-s mbi politikën e Serbisë ndaj Kosovës”²⁶. Po ashtu, theksohet ndikimi i Beogradit në formimin e strukturave paralele në veri; sfidat që kjo i shkakton punës së EULEX-it në forcimin e sundimit të ligjit, përfshirë edhe emërimin e 32 gjykatësve dhe prokurorëve në gjykatat paralele në veri të Mitrovicës në 2009.

Me qëllim të zbatimit të strategjisë, janë ndërmarrë një sërë hapash nga ZCN dhe QeK. Me 5 shkurt 2010, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN) e emëroi Ekipin Përgatitor Komunal (EPK) për Mitrovicë të Veriut²⁷, i cili ka mandat teknik për përgatitjen e të gjitha strukturave burimore, pronësore dhe administrative të nevojshme për themelimin dhe funksionimin e ardhshëm të komunës së re të Mitrovicës Veri²⁸. Me 24 shkurt 2010, Qeveria e Kosovës e emëroi Ylber Hysën koordinator për strategjinë për veri dhe e themeloi një zyrë të vogël për ta përkrahur punën e tij.

Me qëllim që ta dëshmojë kontrollin e vet në veri, Serbia i organizoi zgjedhjet lokale në veri të Mitrovicës me 30 maj 2010. Mbajtja e këtyre zgjedhjeve, të cilat nuk u kundërshtuan nga prania ndërkombëtare në Kosovë, i dha fund Strategjisë së përbashkët të ZCN/QeK.

Përkundër zgjedhjeve lokale të Serbisë të mbajtura në komunat veriore të Kosovës, QeK dhe ZCN vazhduan zbatimin e Strategjisë me hapjen e Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve (QShQ) në veri të Mitrovicës me 2 korrik 2010. Qëllimi i QShQ ishte ofrimi i shërbimeve themelore për qytetarët në veri, si p.sh. certifikatat e lindjes dhe vdekjes, fletë kurorezimit, si dhe letërnjoftimet apo dokumentet e udhëtimit. Ky veprim rezultoi në dhunë nga ekstremistët Serb dhe në vdekjen e njërit dhe disa të lënduar, si dhe me mbylljen e kësaj Qendre²⁹. Qendra është rihapur në maj 2011, dhe ka zgjeruar veprimtarinë e vet duke përfshirë edhe regjistrimin e bizneseve dhe OJQ-ve³⁰. Qendra është ende funksionale.

Këta hapa e hidhëruan elitën politike në Beograd. Serbia reagoi me nervozizëm dhe e solli çështjen para Këshillit të Sigurimit të KB duke besuar se ndërmjetësuesit ndërkombëtarë ishin serioz dhe të vendosur në përkrahjen e tyre të strategjisë për re-

²⁵ Ibid. (p.5)

²⁶ QeK dhe ZCN (2010) Strategjia për Veri të Kosovës. (p.2)

²⁷ ZCN (2010). “Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar Emëron Anëtarët e Ekipit Përgatitor për Komunën e re Mitrovicë Veri” *Kumtesë për Shtyp*. [Online] Gjetet në: <http://www.ico-kos.org/d/100205%20MN%20MPT%20appointments%20English.pdf>

²⁸ EPK Mitrovicë Veri. Gjetur me: 29 Janar 2012. [Online] Gjetet në : <http://www.mpt-mn.org/View.aspx?p=yf/HcYUOXcQ=&u=NR5LUYkYa4g=&type=Lsqt/WcPZo=>

²⁹ Këshilli I Sigurimit të KB (2012). “Presidenti Serb President, Takimi i Këshillit të Sigurimit, Fajëson Shpalljen Unilaterale të Pavarësisë për Dhunën Vdekjeprurëse në Kosovë” Takimi i 6353. [Online] Gjetet në : <http://www.un.org/News/Press/docs/2010/sc9972.doc.htm>

³⁰ ZCN (2011) “Të Gjithë Qytetarët Përfitojnë nga Qendra për Shërbime – Fejt” *Kumtesë për Shtyp* [Online] Gjetet në: http://www.ico-kos.org/ico/data/Image/110525_New_GoK_NM_ENG.pdf

integrimin e veriut të Kosovës në pjesën tjetër të shtetit. Ata theksuan se strategjia ishte vetëm një tentativë që në mënyrë të pavarur të “ndërrohet realitetit” në veri, dhe paralajmëruan për efektet e tij destabilizuese³¹. “Ndërrimi i realitetit” për Beogradin ishte ndryshimi i situatës në terren, e cila i përshtatej Beogradit për të arritur qëllimet e veta fundamentale për ndarjen e veriut të Kosovës.

Ishte ironike fakti që Beogradi frikësohej pasi që strategjia nuk e kishte miratimin e të gjithë partnerëve ndërkombëtarë në Kosovë, KFOR-i, EULEX-i dhe Brukseli siç pritej nga QeK dhe ZCN si sponsorë të kësaj strategjie. Problemi për zbatimin e strategjisë nuk qëndronte vetëm me shtetet që nuk e kishin njohur pavarësinë e Kosovës. Madje as disa nga shtetet anëtarë të GDN nuk e përkrahnin planin³², përderisa BE-ja konsideronte se hartimi i strategjisë nuk ishte konsultuar me Brukselin dhe nuk ishte strategji e Bashkimit Evropian³³. Qartazi nuk kishte interes nga një numër i shteteve anëtare të BE-së për ta ndryshuar status-quo në veri dhe për ta “zemëruar” Serbinë para vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) mbi ligjësinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Andaj zbatimi i strategjisë në aspektin praktik u anulua. Dështimi i “Strategjisë për veriun e Kosovës” ishte një grusht për të gjithë ata që deshën ta shohin zbatimin e planit të Ahtisaarit në veri dhe praktikisht e bën Beogradin palë kyçe për zgjidhjen e problemit të Kosovës në veri.

5. Zbehja e Brukselit dhe ngritja e Berlinit

Më 26 maj 2011, Serbia e arrestoi Ratko Mladiqin, ish-komandantin Serb të Bosnjës i kërkuar nga Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi (TNKJ), për masakrën e Srebrenicës. Lajmi u dha gjersa Përfaqësuesja e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë të BE-s, znj. Kethrin Eshton, kishte shkuar në Beograd për t’i diskutuar kushtet për hyrjen e Serbisë në BE, përfshirë edhe dialogun Prishtinë – Beograd, të ndihmuar nga Brukseli³⁴. Në këtë takim, Tadiq i tha Eshtonit se ai nuk ishte i interesuar të diskutojë për “çështjet praktike” në dialog me Prishtinë, dhe haptazi tha se Serbia dëshiron ndarjen e veriut të Kosovës duke lënë të shokuar Eshtonin³⁵.

Derisa Serbia filloi përmbylljen e kapitullit të bashkëpunimit me TNKJ³⁶, pozita e saj ndaj Kosovës ishte përforcuar. Duke e injoruar kushtëzimin e një bashkëpunimi të mirëfilltë rajonal që duhej ta plotësonte për të arritur statusin e kandidatit anëtare, Beogradi besonte se bashkëpunimi me TNKJ do t’i jepte Serbisë kredit të mjaftueshëm për të fituar statusin e kandidatit, por edhe ndarjen e Kosovës.

Në ndërkohë kur Beogradi shtjellonte këtë çështje, raundi i dytë i dialogut i caktuar për 15 korrik 2012 u shty për shkak se kryenegociatori i Serbisë Borislav Stefanoviq nuk udhëtoi për në Bruksel³⁷. Pjesë e agjendës për këtë raund të dialogut ishte marrëveshja për vulat e doganave të Kosovës, të cilat Serbia nuk i pranonte. Një marrëveshje për vulat doganore ishte shumë me rëndësi për Kosovën, sepse do ta lejonte eksportin dhe transportin e mallrave dhe të shërbimeve përmes Serbisë, gjë që Kosova nuk ka mundur

³¹ Këshilli i Sigurimit të KB (2012). “Presidenti Serb, në Takimin e Këshillit të Sigurimit, Fajëson Shpalljen e njëanshme të Pavarësisë për Dhunën Vdekjeprurëse në Kosovë” *Takimi 353*. [Online] Gjetet në: <http://www.un.org/News/Press/docs/2010/sc9972.doc.htm>

³² Në takimin e 8 shkurtit, 2010 të GDN, Suedia nuk përkrahi strategjinë.

³³ B29. “Strategjia për veri e Kosovës jo e BE-s”. 26 Janar 2010. [Online] gjetet në:

http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2010&mm=01&dd=26&nav_id=64763

³⁴ Dialogu për çështje praktike filloi në Mars 2011 pas rezolutës së APKB A/RES/64/298 e cila doli pas mendimit këshillues të GjND për Kosovën

³⁵ Intervista të shumta të KIPRED më zyrtarë të BE’s, Beograd, Prishtinë dhe Bruksel, Maj/Qershor/Tetor 2011.

³⁶ Me arrestimin e të ikurit të fundit Goran Haxhiq me 20 Korrik 2011

³⁷ Beogradi tentoi të tregohet i vendosur për të mos diskutuar marrëveshjet teknike me Prishtinën më tutje

ta bëj që nga shpallja e pavarësisë. Shtyrja e këtij raundi të bisedimeve e zemëroi opinionin publik në Kosovë, ku QeK u përgjigj me miratimin e “masave të reciprocitetit për tregti” me Serbinë me 20 korrik 2011. Kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi kërkoi nga EULEX-i t’i ndërmarrë hapat për zbatimin e këtyre masave, gjë të cilën e refuzoi EULEX-i³⁸. Më tutje EULEX, i tërhoqi vërejtjen Thaqit se QeK nuk e ka autoritetin të veprojë në veri të lumit Ibër. Në një lëvizje të shpejtë, në mbrëmjen e 25 korrikut 2011, Thaqi i dërgoi ROSU-t në veri për ta vënë kontroll plotë të doganave dhe kësijoj t’i vendos masat e reciprocitetit.

Si rezultat i aksionit të ROSU, njëri nga pjesëtarët e saj u vra gjatë operacionit dhe dy ditë më vonë me 27 korrik 2011, u dogjën doganat e Kosovës në kalimin kufitar në Jarinjë nga grupet kriminale serbe. KFOR reagoi me shpejtësi duke dërguar trupa (gjermane) shtesë në veri për ta penguar përkeqësimin e situatës së sigurisë. Beogradi e dërgoi Stefanoviçin në veri të Kosovës për të negociuar me KFOR-in në emër të serbëve të Kosovës ku u arrit një marrëveshje e përkohshme³⁹ tek kalimet kufitare e vlefshme deri me 15 shtator 2011. Stefanoviçi luajti edhe një rol gjatë qëndrimit në veri; së bashku me Ministrinë për Kosovë dhe Metohi, Goran Bogdanovic i inkurajoi kryetarët lokalë të fillonin ngritjen barrikadave në rrugët kryesore të veriut të Kosovës për ta penguar çfarëdo tentative të QeK për ta vendosur kontrollin në veri, dhe kësijoj të bëhej një ndarje de-facto fizike. Serbisë dhe institucioneve paralele iu deshën dy javë për ta mobilizuar me forcë popullatën lokale serbe për të dalë në barrikada⁴⁰. Serbët lokalë, të lodhur nga paqëndrueshmëria dhe pasiguria në të cilën kanë jetuar për më tepër se një dekadë, thjesht nuk donin të merrnin pjesë në këtë konflikt kompleks politik.

Përkundër këtyre tensioneve, Kancelarja Gjermane Angela Merkel e vizitoi Beogradin me 23 gusht 2011. Ajo ia parashtrori kushtet më të qarta që një shtet perëndimor ia kishte thënë ndonjëherë Beogradit, plotësimi i të cilave do ta përcaktonte progresin e mëtutjeshëm të Serbisë drejt anëtarësimit në BE. Kancelarja Merkel e kushtëzoi Serbinë me vazhdimin e dialogut me Kosovën, të arrihen marrëveshje dhe të zbatohen ato, t’i lejohet EULEX-it të veprojë nëpër tërë Kosovën, të shpërbëhen strukturat paralele, si dhe të mos krijohen struktura të tilla të reja në veri të Kosovës. Po ashtu, Kancelarja Merkel i tha Tadiçit se ndarja e veriut përjashtohet.

Kushtëzimi i Gjermanisë e tronditi udhëheqjen e Serbisë dhe e fundosi synimin e Beogradit për ndarje të Kosovës. Ky veprim gjerman e tronditi edhe Brukselin, sepse Komisioni i BE-s ishte duke punuar për të dhënë mendim pozitiv për statusin kandidat të Serbisë, pa marrë parasysh raportet e Serbisë me Kosovën. Beogradi e kuptoi se nëse nuk i plotëson kushtet e Berlinit, i cili kishte përkrahjen e Londrës dhe Uashingtonit, Serbia jo vetëm që do të pengohet në përparim drejt BE-s, por edhe do t’i përkeqësoheshin raportet e rëndësishme bilaterale ekonomike dhe politike me Gjermaninë⁴¹.

Duke e kuptuar se ndarja e Kosovës nuk është e arritshme në këtë kohë, Presidenti Tadiç e paraqiti planin e Beogradit për “normalizim” të raporteve me Kosovën duke mos e njohur atë. Ky plan përbëhet nga 4 pika: (1) status special për veriun e Kosovës, (2) administrim të manastireve serbe dhe komplekseve monastike, (3) garanci speciale për serbët në enklava, dhe (4) rregullore rreth pasurisë së qytetarëve serbë dhe të shtetit të

³⁸ KIPRED intervista me EULEX dhe zyrtarë të Qeverisë të Kosovës, 27 Korrik, 2011. EULEX thotë se është “kundër praktikave të BE-s të ndihmojë ndalesat të tregtisë”.

³⁹ Në bazë të kësaj marrëveshje të përkohshme, kalimet kufitare në veri të Kosovës do të mbahen nën mbikëqyrjen e KFOR-it.

⁴⁰ Serbët e Kosovës në veri të cilët punojnë në institucionet paralele u urdhëruan të shkojnë në barrikada përndryshe do të humbin vendet e punës.

⁴¹ KIPRED intervista me Zyrtarë të Lartë Perëndimor, Prishtinë, 25.01.2012

Serbisë. Këto pika dukej që siguronin se integriteti territorial i Kosovës mbetej i padiskutueshëm. Ambasadori francez dhe ai anglez në Prishtinë dhe Beograd e theksuan se 4 pikat e Tadiq mund të gjenden në parimet e planit të Ahtisaarit, përderisa diplomatët gjermanë dhe ata nga ShBA nuk kanë thënë asgjë publikisht. Prishtina në anën tjetër e refuzoi planin.

Dhjetë ditë pas vizitës së Merkelit në Beograd, më 2 shtator 2011, filloi dialogu mes Serbisë dhe Kosovës. Serbia i pranoi vulat e doganave të Kosovës duke shpresuar se do të fitojë statusin e kandidatit në dhjetor. Me 16 shtator 2011 Prishtina i dërgoi doganierët në portat 1 dhe 31 me ndihmën e EULEX-it dhe të helikopterëve të KFOR-it. Serbët lokalë, të përkrahur nga Beogradi, reagueshan duke ngritur barrikada të reja dhe duke i forcuar të mëparshmet në rrugët kryesore në veri të Kosovës, duke e radikalizuar situatën dhe duke e thelluar edhe më shumë status quo-në. Me 27 shtator 2011, një numër ushtarësh të KFOR-it dhe serbësh të Kosovës u lënduan gjatë të shtënave tek pika doganore në Jarinje pasi që KFOR tentoi ta largonte barrikadën më të madhe të rrugës. Përbalja më e dhunshme mes KFOR-it dhe serbëve të Kosovës ndodhi me 23 nëntor 2011, kur KFOR-i tentoi edhe njëherë t'i largonte bllokadat e rrugëve, e që rezultoi në lëndimin e 21 ushtarëve të KFOR-it dhe të një numri të serbëve të Kosovës⁴². Ishte ky incident si dhe paaftësia e Serbisë që t'i kontrollonte radikalët e veriut që e përcaktoi vendimin e Gjermanisë në përdorimin e vetos ndaj statusit kandidat të Serbisë⁴³. Gjermania e kishte përsëritur se derisa Serbia nuk i merr me seriozitet raportet dhe marrëveshjet e arritura me Kosovën, dhe fillon t'i shpërbëjë strukturat paralele, asaj nuk do t'i jepej statusi kandidat. Në raundin tjetër të bisedimeve u arritën marrëveshje të reja mes Serbisë dhe Kosovës, si ajo e diplomave universitare dhe më e rëndësishmja ajo e menaxhimit të integruar të kufijve (IBM⁴⁴).

Në një luftë mes vet serbëve të ndërlidhur me zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Serbi, kryetarët e komunave veriore filluan ta kundërshtojnë Beogradin dhe marrëveshjen IBM, si dhe e caktuan mbajtjen e një referendumi në mesin e muajit shkurt 2012. Pyetja në referendum do të ishte "A i pranoni institucionet e të ashtuquajturës Republikë e Kosovës?". Serbët në jug të Ibrit protestuan kundër këtij vendimi duke u frikësuar nga ndarjet e tjera përbrenda vet komunitetit serb, gjersa një refuzim paksa më i butë por unanim erdhi nga Beogradi me pretekst se referendumi do të vepronte kundër interesave kombëtare serbe. Udhëheqja e Serbisë filloi të kërkonte nga serbët e veriut ta "shtynin" këtë hap pasi do të shpinte në vonesa të mëtejme në procesin e anëtarësimit në BE-s.

Derisa retorika e Tadiqit forcohej kundër serbëve të veriut të Kosovës, ai filloi të kërkonte biseda politike dhe ta impononte planin e tij 4 pikësh, duke e bërë edhe më të vështirë dialogun e udhëhequr nga Brukseli. Kjo gjë e provokoi Uashingtonin të intervenonte duke i kërkuar Beogradit normalizim e marrëdhënies mes Serbisë dhe Kosovës para vendimit të Këshillit Evropian në mars për statusin kandidat të Serbisë. Njëkohësisht, Prishtina ishte pyetur se cila ishte "oferta" e saj për veriun dhe i është kërkuar ta hartonte një vizion për integrimin dhe akomodimin e veriut, përfshirë këtu edhe arsyet ekonomike e politike për serbët lokalë. Prishtina vazhdon të mbetet pasive, derisa partnerët perëndimor pajtohen në qëndrimin e tyre për veri, duke mos e kuptuar se pa marrë parasysh ekzistimin e konsensusit apo mungesës së tij, veri i Kosovës dhe ri-integrimi është problem i Prishtinës dhe është obligim i Kosovës që ta udhëheq këtë proces.

⁴² Judah, T. "Përlëshjet në Kosovë: Marrëveshjet e kryera jo më". 24 Nëntor 2011. *The Economist*. [Online] <http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2011/11/clash-kosovo>

⁴³ MB dhe Holand po ashtu dhanë veto në statusin kandidat të Serbisë

⁴⁴ Në gjuhën angleze – Integrated Border Management (IBM)

6. Shumë elemente në lëvizje gjatë vitit 2012

Me 24 janar 2012, Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) mbajti takimin e katërbëdhjetë në Vjenë. GDN shpalli se Kosova po hyn në hapat përfundimtar të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Status (PGjS)⁴⁵, dhe se duhet të fillojnë përgatitjet për “një fund të organizuar” të pavarësisë së mbikëqyrur dhe mbylljes së ZCN⁴⁶. Po ashtu, GDN njoftoi se e kishte miratuar një pako të amendamenteve të Kushtetutës së Kosovës dhe të legjislacionit primar për t’i hequr të gjitha elementet e mbikëqyrjes ndërkombëtare. Në një thirrje të paprecedentë GDN kërkoi nga Serbia të tërheq praninë policore, sigurimin apo çfarëdo pranie shtetërore nga veriu i Kosovës, si dhe të mos mbajë zgjedhje lokale atje. Kjo është hera e parë që ndonjë shtet apo organizatë ndërkombëtare zyrtarisht e pranonte praninë e aparatit të sigurimit shtetëror të Serbisë në veri. Sa i përket veriut, GDN ritheksoi “parimet bazë” të Planit të Ahtisaarit, të cilat ofrojnë të ardhmen më të mirë për komunat veriore të Kosovës.

Qëllimet e Presidentit Tadiq për bashkëpunim me Prishtinën në bazë të kërkesave të perëndimit do të testohen gjatë 2012 duke marrë parasysh kalendarin zgjedhor të Serbisë⁴⁷. Ka tri pika përcaktuese për zgjedhjet parlamentare dhe lokale të majit, dhe zgjedhjeve presidenciale të dhjetorit në Serbi. E para është fokusi i brendshëm i cili do të sjellë përgjigje të ngadalësuar në zbatimin e marrëveshjeve me Prishtinën të arritura përmes dialogut të ndihmuar nga Brukseli. E dyta është mundësia e organizimit të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës. E treta është rezultati i papritur në zgjedhje dhe mundësia e fitores së Tomislav Nikoliqit. Gjasat e tanishme të Tadiqit për kompromis mund të shihen në tentativë për ta fituar statusin kandidat në BE që në fillim të marsit, vetëm pak para 11 marsit 2012, datë kur caktohet dita e zgjedhjeve lokale. Nëse i shtohen edhe disa muaj të fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale të dhjetorit, Serbia do të konsumohet me vetveten gjatë tërë vitit 2012. Andaj, nuk është reale të pritët nga Beogradi të angazhohet në mënyrë konstruktive në gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme afatgjate për veriun e Kosovës përbrenda Planit të Ahtisaarit, për shkak se asnjëra palë nuk do të shihet “se po e jep” Kosovën ose po e kundërshton BE-në gjatë vitit të plotë zgjedhor.

Nuk ekziston konsensus në bashkësinë ndërkombëtare nëse Serbia duhet t’i organizojë ose jo zgjedhje lokale në veri të Kosovës, përkundër kërkesës nga GDN se Serbia nuk duhet të bëjë diçka të tillë. Me 9 mars 2012, BE do të vendos për statusin kandidat të Serbisë ndërsa me 11 mars 2012 Serbia do ta shpall datën e zgjedhjeve parlamentare dhe lokale përfshirë këtu edhe vendimin nëse do të organizohen zgjedhjet në veri të Kosovës. Kjo pjesë e vendimit do të thotë se BE duhet të vendos t’i ofrojë Serbisë karotën para se Serbia të tregohet se ka ndryshuar qasjen ndaj Kosovës. Andaj Serbia mund të motivohet të vazhdojë më tutje në organizimin e zgjedhjeve në veri. Kjo do t’i shërbente Tadiqit për t’u treguar para elektoratit në Serbi se ai po e mban premtimin e vet të politikës “edhe BE edhe Kosovë”. Si rezultat Serbia mund të përfundojë me marrjen e statutit kandidat pa e ndryshuar qasjen ndaj Kosovës siç e kishte kushtëzuar Gjermania.

Organizimi i zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës mund të jetë hap vendimtar drejt një varg konsekuencash negative jo vetëm për Kosovën por për tërë rajonin. Zgjedhjet do ta ndanin komunitetin serb në veri nga pjesa tjetër e vendit dhe bashkatdhetarët e tyre në jug të lumit Ibër. Kjo po ashtu do të vinte bazat e kontrollit të Serbisë dhe të

⁴⁵ ZCN. (2012). “Takimi i katërbëdhjetë i Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën” [Online] Gjetet në: http://www.ico-kos.org/ico/data/Image/2012_ISG_Vienna_Communique_ENG.pdf

⁴⁶ Ibid

⁴⁷ Që nga shpallja e pavarësisë të Kosovës në 2008, Beogradi deklaroi se ishte veprim kundër Rezolutës 1244, organizoi zgjedhjet lokale (për herë të parë pas 1999) në tërë Kosovën me qëllim të shprehjes së kundërshtimit të pavarësisë të Kosovës dhe kësaj që tregohet si vendimmarrës për vendbanimet Serbe në Kosovë.

institucioneve të Serbisë në veri si dhe do të fitonte kredibilitet i ashtuquajtur “realitet tjetër”. Ky “realitet tjetër” që do të krijohet nga këto zgjedhje do t’i shkonte përshtati perëndimorëve të cilët e përkrahin⁴⁸ planin 4 pikësh të Tadiqit, i cili kërkon “status special” për veriun e Kosovës. Derisa tri nga këto pika kanë të bëjnë me të drejtat e serbëve (njerëzve dhe pronën) në Kosovë, çka edhe parashihen në Planin e Ahtisaarit, pika e katërt e “statusit special” për veri ka të bëjë me “status dhe të drejtat të shtuara të serbëve në ato komuna të veriut të Kosovës ku serbët janë shumicë, duke formuar një rajon të vetëm të quajtur Veriu i Kosovës me të drejta speciale të përfaqësimit”⁴⁹. Ky “status special” për veriun nuk është pjesë e Planit të Ahtisaarit, përkundrazi deklaratave të disa diplomatëve perëndimor se këto pika mund të gjenden në të.

Plotësimi i planit të Beogradit nuk do të krijonte vetëm një shtet jofunksional por do të përkeqësonte situatën e serbëve në jug të lumit Ibër, si dhe do të ngrinte menjëherë tensionet ndëretnike përbrenda Kosovës. Po ashtu, do t’i kthente kërkesat për status “reciprociteti” në mes të Kosovës dhe Luginës së Preshevës; do t’i forconte zërat në Prishtinë për shkëmbim territoresh – veriun e Kosovës Serbisë, ndërsa Luginën e Preshevës Kosovës ose për shpërbërje të shtetit dhe bashkim me Shqipërinë. Nëse do të krijohet “rajoni verior i Kosovës”, gjatë dekadës së ardhshme ose pak më vonë, kjo do të shkëputet dhe de-facto do të bëhet pjesë e Serbisë. Beogradi, në anën tjetër me bekimin e bashkësisë ndërkombëtare do të paraqitet si mbrojtës “i paqes dhe stabilitetit” në Bosnje – duke kontrolluar Republikën Serbe, dhe në Kosovë – përmes kontrollit të “rajonit verior të Kosovës”, portret ky i paqenë ashtu siç edhe ka ndodhur pas nënshkrimit të Dejtonit në 1995. Ky skenar do të sillte në pyetje ekzistencën e Kosovës si shtet dhe do të ishte grusht fatal për angazhimin prej dy dekadash të bashkësisë ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor për krijimin e shoqërive shumetnike .

Kosova gjithashtu do të konsumohej gjatë viti 2012. Nxitimi për ta përfunduar mbikëqyrjen e pavarësisë e ndryshon kalendarin zgjedhor dhe prioritet politik të Kosovës. Zgjedhjet presidenciale që do të mbaheshin në qershor të vitit 2012 janë shtyrë. Andaj viti 2013 për Kosovën do të jetë vit i plotë zgjedhor ku përpos zgjedhjes së presidentit të ri, do të mbahen zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Në pjesën e prioritetëve politikë, GDN ka kërkuar amendamente të Kushtetutës, të cilat do të mbajnë Qeverinë e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare të zënë në përgatitjen e adaptimit të amendamenteve të nevojshme, të cilat kërkojnë pajtimin e partive opozitare. Ky angazhim gjithëpërfshirës i institucioneve do të lë hapësirë të ngushtë për angazhim në ndryshimin e status quo në veri të Kosovës. Nëse status quoja e tanishme në veri mbetet kështu do të krijonte ndarje të thellë në spektrin politik të Kosovës dhe do të rriste potencialin për konflikt.

7. Rruga përpara

Duke u bazuar në kërkesën e Komisionit Evropian të tetorit të vitit 2011 që Kosova “ta iniciojë një agjendë gjithëpërfshirëse për veri”⁵⁰, Prishtina me urgjencë duhet ta hartojë një plan të detajuar për ri-integrimin e kësaj pjesë. Por duke marrë parasysh përvojën e hidhur me “Strategjinë për veri të Kosovës” dhe ndarjet përbrenda BE-s, Brukseli duhet të jetë i bashkuar në menaxhimin politik të këtij procesi si parakusht për të ecur përpara. Plani i pranuar duhet të ketë edhe përkrahjen e Uashingtonit. ShBA-të dhe BE-ja duhet

⁴⁸ Gjatë kohës së shkrimit të këtij punimi, 4 pikat e planit të Tadiqit kanë filluar të marrin pëlqimin nga aktorët e ndryshëm ndërkombëtar.

⁴⁹ Dokumenti i cili paraqet detajet e planit 4 pikësh të Tadiqit i qarkulluar te KIPRED

⁵⁰ Komisioni Evropian (2011) “Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin [Online] Gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/strategy_paper_2011_en.pdf

ta japin tërë forcën politike për ta stabilizuar Ballkanin Perëndimor dhe t'i bëjnë presion Serbisë mos t'i mbajë zgjedhjet në veri të lumit Ibër, si dhe të jenë të vendosur për zbatimin e planit të Ahtisaarit në veri. Pëlqimi i Beogradit do të ishte shenjë se Serbia është e interesuar për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

KIPRED propozon këtë plan të panegociueshëm që duhet:

- të bazohet vetëm në dispozitat e planit të Ahtisarit;
- të ketë parasysh perspektivën evropiane të Kosovës dhe stabilitetin rajonal;
- të përkrahët politikisht dhe funksionalisht nga BE-ja, ShBA-të dhe NATO-ja;
- ta ngritë besimin mes QeK, serbëve në veri, dhe Serbisë, dhe të jetë në funksion të pajtimit ndëretnik në Kosovë;

KIPRED i propozon fazat në vijim për ta akomoduar veriun e Kosovës:

a. Faza e I: Faza emergjente (3 muaj)

(1) BE aplikon kushtëzimin strikt ndaj Serbisë

- BE kushtëzon Serbinë të vendosë para 9 marsit 2012 që nuk do t'i mbajë zgjedhjet komunale në veriun e Kosovës;

(2) Themelimi i Këshillave Tranzitorë Komunalë për 4 komuna (KTK)

- KTK-të do të jenë organe të përfaqësuara nga udhëheqësit e partive të komuniteteve të cilat jetojnë në veri të Kosovës;
- Themelimi i KTK-ve të udhëhiqet nga Zyra e BE-s në Kosovë;
- Duke i përfaqësuar komunitetet që jetojnë në veri të Kosovës, KTK-të do të jenë organet me përgjegjësi për: komunikimin me QeK për vendosjen e sundimit të ligjit në veri; për krijimin e komunës së Mitrovicës veriore; për koordinim me Zyrën e BE-së në Kosovë, EULEX, OSBE dhe KQZ-në e Kosovës për organizimin e zgjedhjeve në 4 komunat veriore;
- KTK-të do ta koordinojnë ndarjen e fondeve për projekte të infrastrukturës në komunat veriore;
- KTK-të do të pushojnë së funksionuari menjëherë pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në 4 komunat veriore;

(3) Zbatimi i sundimit të ligjit

- Duhet të fillojë tërheqja e plotë e institucioneve dhe personelit paralel të sigurisë. Kontratat dhe çfarëdo marrëveshje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë mes të MPB dhe zyrtarëve të Policisë së Kosovës duhet të ndërpritet. Serbia duhet të përkushtohet dhe të jetë transparente në këtë proces përderisa aktiviteti duhet të mbikëqyret, vëzhgohet dhe verifikohet nga KFOR, EULEX dhe Policia e Kosovës; dhe të raportohet tek Këshilli Evropian, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian;
- EULEX duhet të ndajë së paku 30-40% të policëve, doganierëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve për rivendosjen e suksesshme të sundimit të ligjit në veri;

- Duhet të sigurohet funksionimi i gjykatave dhe i Policisë së Kosovës në veri të Kosovës. Gjyqtarët dhe prokurorët lokalë duhet të propozohen e pranohen, si dhe të autorizohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK) para se të emërohen nga Presidenti i Kosovës;
- KFOR-i duhet të krijojë një hapësirë të besimit dhe një mjedis për zbatimin fillestar të sundimit të ligjit;

(4) Zbatimi i plotë i IBM, tabelave të regjistrimit dhe i marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes

- Marrëveshja e IBM në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të realizohet, fillimisht duke instaluar poste lëvizëse (të cilat do ta lehtësonin përkushtimin logjistik nga të dyja palët);
- Marrëveshjet për lirinë e lëvizjes dhe e tabelave të regjistrimit të automjeteve të arritura mes Serbisë dhe Kosovës duhet të zbatohen;
- Vendosja e pandërprerë e doganierëve dhe Policisë së Kosovës tek kalimet kufitare duhet të jetë e pandërprerë dhe e pranueshme;
- Demilitarizimi i kalimit kufitar tek porta 31;

(5) Krijimi i ‘Fondit Special Zhvillimor’ nga Qeveria e Kosovës për komunat Mitrovicë e Jugut, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, dhe Leposaviq

Krijimi i fondit të tillë duhet të shërbejë si model i krijimit të fondeve të ngjashme për rajonet tjera të pazhvilluara të Kosovës

- Fondi do të përdorej për (i) përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës në 5 komunat (p.sh. furnizim me ujë, rrymë, avancimet teknologjike dhe teknike në arsim, shëndetësi, bujqësi, transport publik); (ii) stimulimin dhe përkrahjen e investimeve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme;
- ‘Fondi Special Zhvillimor’ do të siguronte zgjerimin e të gjitha projekteve të ndërmarra në sferat e lartpërmendura për të përfshirë të gjitha komunat nëse është e mundur (p.sh. nëse projekti fillon në jug duhet të zgjerohet edhe në veri);
- ‘Fondi Special Zhvillimor’ duhet të jetë i hapur për donacione nga donatorët, përfshirë edhe QeS;
- Fondi duhet të mbikëqyret dhe menaxhohet nga një bord i përbërë nga përfaqësuesit e 5 komunave përfituese, ministritë përkatëse të QeK dhe Zyrës së BE-së;
- Nëse të hyra që grumbullohen në portat 1 dhe 31 duhet të shkojnë për komunat veriore atëherë ato të duhet të derdhen në këtë “Fondin Special Zhvillimor”, ashtu që të përfitojnë të 5 komunat së bashku;

b. Faza e II: Faza e akomodimit (1 vit)

(1) Funkcionalizimi i EPK Mitrovicë Veri

- Misioni i UNMIK-ut në Mitrovicë duhet të përfundojë paralelisht me funksionalizimin e EPK Mitrovicë e Veriut (3 muaj)

(2) Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe të drejta në komunat veriore

- Zgjedhjet komunale në veri të Kosovës do të organizohen nga KQZ e Kosovës në koordinim dhe bashkëpunim të plotë me KTK-të dhe Zyrën e BE-s;
- Këto zgjedhje duhet të vëzhgohen nga Parlamenti Evropian dhe OSBE-ja;
- Këto zgjedhje duhet të njihen nga Serbia në mënyre të hapur;

(3) Operacionalizimi i rrjedhës transparente të fondeve pas përfshirjes në bashkëpunim kufitar të komunave

- Komunat në veri të Kosovës do të pranojnë fonde nga Serbia dhe vendet tjera përmes procedurave të ofruara me ligj⁵¹;
- Ky bashkëpunim duhet të marr formën e dhënës së ndihmave teknike dhe financiare nga institucionet e Serbisë, përfshirë pajisjen dhe personelin për zbatimin e kompetencave komunale;

(4) Fillimi i zbatimit të pakos për zhvillim ekonomik për veri të Kosovës⁵², e i cili do të përfshinte gjithashtu edhe komunën e Mitrovicës së Jugut.

Përpos 'Fondit Special Zhvillimor' QeK duhet të krijojë:

Hapësira për investime speciale

Krijimi i hapësirës së tillë duhet të shërbejë si model i krijimit të hapësirave investuese të ngjashme për rajonet tjera të pazhvilluara të Kosovës

- Të mbulojë territorin e pesë komunave – Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit;
- Qëllimi i krijimit të kësaj hapësire është të ofrojë një mekanizëm të rivitalizimit ekonomik të qëndrueshëm për hapësirën e de-industrializuar dhe për të ofruar stimuj atraktiv për investitorë direkt të huaj dhe vendorë, si dhe punësim të menjëhershëm të pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve;
- Kjo hapësirë duhet të mbikëqyret nga një organ i përbërë nga Ministria e Financave dhe përfaqësuesve të të pesë komunave;
- Kompanitë të cilat do të zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik në këtë hapësirë duhet të lirohen nga pagesat e (për një periudhë 5-10 vjeçare):
 - Taksave komunale (licencim, tatimi në pronë, etj);
 - Tatimit në fitim në nivelin qendror;
- Nga kompanitë do të kërkohet të paguajnë të gjitha tatimet tjera (tatimet në të ardhura, kontributet për punëtor, TVSh në mallra dhe shërbime);
- Në këtë aspekt autoritetet komunale duhet të ofrojnë tokën pa pagesë në shkëmbim të punësimit, si dhe një plan adekuat të investimit për një periudhë 10 vjeçare;

⁵¹ Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, Neni 30: Bashkëpunimi Përtej-Kufijve të Komunave

⁵² Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi